



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. Prot.

Vlorë, më 02.03.2018

**Vendim
Nr. 4, datë 02.03.2018**

**PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT NË TË GJITHA NIVELET NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Bazuar në nenin 49/1/ç të ligjit nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 02.03.2018,

VËREN SE:

Me vendimin nr. 8, datë 14.02.2018 të Senatit Akademik "*Për strukturën organizative të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë*", është miratuar struktura organizative e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë në të gjitha nivelet. Në këtë vendim është përcaktuar gjithashtu në mënyrë të qartë dhe varësia që do të ketë personeli në nivel institucioni dhe në nivel njësie bazë. Në vendim përcaktohet qartë se strukturat administrative janë në varësi të administratorit, ndërsa njësia e auditit është në vatësi të Bordit të Administrimit. Gjithashtu në dispozitiv është përcaktuar se struktura organizative do të jetë pjesë e Statutit të ri të U.V sipas nenit 33 të ligjit nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", si dhe udhëzimit nr 27, datë 29.12.2017 të Ministrit të Arsimit Rinisë dhe Sportit "*Për strukturën e brendshme akademike dhe administrative të IAPL-ve*".

Me vendimin nr. 9, datë 14.02.2018 të Senatit Akademik "*Për organigramën e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë*", është miratuar organigrama e Universitetit.

Organigrama do të jetë gjithashtu pjesë e statutit të ri në respektim të nenit 33 të ligjit nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", si dhe udhëzimit nr 27, datë 29.12.2017 të Ministrit të Arsimit Rinisë dhe Sportit "*Për strukturën e brendshme akademike dhe administrative të IAPL-ve*".

Me vendimin nr. 10, datë 14.02.2018 të Senatit Akademik "*Për propozimin e numrit të personelit të të gjitha niveleve në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë*", i është miratuar propozuar Bordit të Administrimit numri i personelit në të gjitha nivelet e institucionit.

Bordi i Administrimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e sipërcituar, konstaton se numri i propozuar nga ana e Senatit Akademik nuk ka ndryshuar në raport me numrin e miratuar në vitin 2017. Gjithashtu B.A konstaton se numri i personelit, i pasqyruar në organigramë dhe në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

strukturën e universitetit përmbush detyrimet ligjore të tij për të siguruar qëndrueshmërinë financiare si dhe mirëmenaxhimin e fondeve, në funksion të punës së përditëshme si dhe studentëve të universitetit.

Bordi i Administrimit konstaton se struktura është organizuar në katër drejtori. Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Edukimit për Ciklin e parë dhe të dytë, Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional si dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

Drejtoritë janë organizuar në sektorë, ku disa prej sektorëve kanë përgjegjës ndërsa në Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore nuk ka përgjegjës në asnjë prej dy sektorëve, pavarësisht se në këtë drejtori ka tetë specialistë në total për dy sektorët.

Në Drejtorinë e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë, e cila është organizuar në tre sektorë, sektori i kurikulave dhe shërbimit ndaj studentëve nuk ka përgjegjës edhe pse ka gjashtë specialistë në përbërjen e saj.

Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional ka tre sektorë në përbërjen e saj, ku Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional nuk ka përgjegjës.

Në këto kushte, duke parë rëndësinë e veprimtarisë dhe kompetencave të këtyre drejtorive, sugjerojmë/propozojmë që ato të organizohen duke u caktuar përgjegjës në krye të sektorëve nga specialistët brenda sektorëve.

Këto propozime, reflektojnë dhe ruajnë të njëjtin standard për të gjithë strukturën dhe për rrjedhojë do të bënin të mundur që shërbimi ndaj studentëve si dhe llogaridhënia përpara drejtuesit të ishin më të mira. Ndryshimet në strukturë nëse miratohen, duhet të pasqyrohen dhe në shkresat që bëjnë përshkrimin e punës, të drejtat dhe detyrimet e personelit.

Njëkohësisht Bordi i Administrimit vlerëson se caktimi i këtyre përgjegjësve nuk ka efekte financiare të larta për buxhetin e Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë pasi nuk ndryshon në total numri i personelit.

Në këto kushte Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 02.03.2018,

VENDOSI:

1. Të miratojë numrin e personelit në të gjitha nivelet në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë gjithësej **354** (treqind e pesëdhjetë e katër) të shpërndarë si më poshtë:

- a)** Numri i personelit akademik me angazhim me kohë të plotë **240** (dyqind e dyzetë).
- b)** Numri i personelit ndihmës akademik me karakter administrativ në nivel institucioni **41** (dyzet e një).
- c)** Numri i personelit ndihmës akademik me karakter administrativ në nivel njësie kryesore **21** (njëzet e një).
- d)** Numri i personelit ndihmës akademik me karakter administrativ në nivel njësie bazë **2** (dy).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

- e) Numri i personelit ndihmësakademik me karakter mësimor në nivel njësie bazë **15** (pesëmbëdhjetë)
 - f) Numri i personelit administrativ në nivel institucioni **35** (tridhjetë e pesë).
 - g) Numri i personelit akademik me kohë të pjesshme **120** (njëqind e njëzetë)
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr. Rezana Vrapit – Kryetar

Ornela Koleka – anëtar

Florian Nurçe – anëtar

Dr. Enida Pulaj – anëtar

Dr. Marinela Muço – anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj – anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT